



Историја - Албански

EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI
HISTORI

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE

VENDI

KOMUNA

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola**: <https://mojasrednjaskola.gov.rs> duke vendosur numrin e veçantë identifikues të nxënësit (shifra dhjetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

Shifra e veçantë e testit: 220202512331

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të çaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë çasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

UDHËZIME PËR PUNË

- Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për plotësimin e testit në dispozicion ke **120 minuta**.
- Detyrat nuk është e thënë t'i zgjidhësh sipas radhitjes së paraqitur.
- Gjatë punës mund të përdorësh laps grafik dhe gomë, por nuk mund ta përdorësh kalkulatorin dhe telefonin mobil.
- Përgjigjet përfundimtare dhe ecurinë shkruaji me **laps kimik ngjyrë të kaltër**.
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps grafik, laps kimik me ngjyrë të zezë ose laps “shkruaj – fshij” nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuar.
- Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë rrethon apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
- Ke kujdes, ngase detyrat dallojnë nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
- Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet (), të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Tek detyrat të cilat kanë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rrathë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e saktë.

SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR	
Tek detyra me një përgjigje të saktë	
Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.	
☐ Novi Sadi ☒ Beogradi ☐ Nishi ☐ Krushevc	
Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta	
Ngjyros rrathët para shprehjes, shuma e të cilës është 5.	
☒ 2 + 3 ☐ 1 + 2 ☒ 4 + 1 ☐ 2 + 4 ☐ 3 + 5	

- Nëse e përfundon testin më herët se sa koha që është paraparë, atëherë dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!



PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR
TESTI
HISTORI

1. Si quhet periudha kohore që zgjat dhjetë vite?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ dekada ☐ shekulli ☐ mileniumi ☐ epoka
2. Cakto cilit shekull dhe cilës dekadë i takon viti 1796 në të cilën mjeku anglez Eduard Xhener për herë të parë me sukses testoi vaksinën kundër lijës së madhe (Variola Vera).
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ shekulli i shtatëmbëdhjetë dhe dekada e nëntë ☐ shekulli i shtatëmbëdhjetë dhe dekada e dhjetë
☐ shekulli i tetëmbëdhjetë dhe dekada e nëntë ☐ shekulli i tetëmbëdhjetë dhe dekada e dhjetë
3. Cilës periudhë historike i takon viti 1908 në të cilën u zhvillua Revolucioni i Gjonturqëve e cila tronditi Perandorinë Osmane?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ shekullin e vjetër ☐ shekullin e mesëm ☐ kohën e re ☐ kohën bashkëkohore
4. Çfarë do të thotë termi pacifizëm?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ bindja politike mbi pabarazinë e popujve ☐ idea ose lëvizja që i kundërvihet dhunës për zgjidhjen e konfliktit
☐ mënyra e realizimit të lirisë me mjete luftarake ☐ rregullimi shtetëror në të cilën qeverisja e lartë kryen punët e pushtetit ushtarak
5. Në cilën nga shtetet e poshtë shënuara gratë në Serbi kanë fituar të drejtën e votës në zgjedhje?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ Mbretërinë Serbe ☐ Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene
☐ Mbretërinë Jugosllave ☐ Republikën Popullore Federative të Jugosllavisë
6. Si quhet periudha historike në të cilën gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIV ndodhi dobësimi dhe zhdukja e Mbretërisë Serbe?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ golgota serbe ☐ shpërngulja e madhe
☐ koha e vdekjeve ☐ koha e udhëheqësve të krahinave





7. Cili është shkaku kryesor për fillimin e Luftës së Ftohtë?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ ngritja e murit të Berlinit ☐ themelimi i Lëvizjes të painkuadruarve
☐ dëshira për sundimin dhe ndikimin e fuqive të mëdha ☐ hapja e fronteve të zjarrit në Afrikë dhe Azi

8. Lexo fragmentin nga burimet historike dhe cakto për cilën ngjarje historike flitet.

„Pra, ne si përfaqësues të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të bashkuar, i drejtohem gjykatës më të lartë botërore: qëllimet tona janë të sinqerta dhe qëllim mirë dhe i realizojmë në emër të popullit të mirë të këtyre kolonive... zyrtarisht paraqesim dhe lajmërojmë që këto koloni të bashkuara kanë të drejtë të lirsë, pavarësisë dhe këto janë...

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ shpalljen e pavarësisë nga Britania e Madhe ☐ fillimi i luftës civile në SHBA
☐ hyrja e SHBA-ve në Luftën e Dytë Botërore ☐ kolonizimi i kontinentit amerikan

9. Lexo me kujdes tekstin nga burimet historike dhe përgjigju në pyetjet.

„Çdo herë kur sulmohet një vend dhe popullin e shkatërrojnë, atëherë shkrimtari i mbretit menjëherë pas tyre shkon dhe të gjithë djemtë, për jeniçer i merr, dje për çdonjërin pesë ari i jep dhe i dërgon përtej detit (në Anadoll, ku i edukojnë për jeniçer). Këso djem ishin përreth dy mijë.”

Cila ngjarje është përshkruar në tekst?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ shkuarja për hajduk ☐ mbledhja e fëmijëve për lufta kryqtare
☐ taksa në gjak ☐ mbledhja e haraçit

10. Ngjyros rrethin në fushën e duhur për të lidhur ngjarjet historike dhe betejat në të cilat zhvillohen.

	Beteja e Kollubarës	Beteja e Kurskës	Beteja e Kumanovës
Lufta e Parë Botërore	☐	☐	☐
Lufta e Parë Ballkanike	☐	☐	☐
Lufta e Dytë Botërore	☐	☐	☐





11. Për cilën periudhë lidhet lindja e monarkisë absolute në Europë?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- | | |
|--|--|
| ☐ mesjeta e hershme (deri në shekullin e XII) | ☐ mesjeta e vonshme (deri në fund të shekullit XV) |
| ☐ koha e re e hershme (në fund të shekullit XVIII) | ☐ koha e re e vonshme (deri në fillim të shekullit XX) |

12. Si quhet protestat e vitit 1968 që përfshinë gjithë Europën dhe RSFJ?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- | | |
|---|---|
| ☐ revolucionin kulturor | ☐ demonstratat e studentëve |
| ☐ kryengritja e listave të bardha | ☐ pranvera punëtore |

13. Çka paraqet një prej pasojave më të rëndësishme të Kryqëzatës së Katërt në territorin e Serbisë mesjetare?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- | | |
|--|--|
| ☐ hyrja e shtetit serb në luftërat kryqtare udhëtimit për në Jerusalem | ☐ ngritja e shtetit në mbretëri në vitin 1217 |
| ☐ ardhja e dinastisë së Nemanjiqëve në pushtet | ☐ bartja e selisë së arqikeshkopisë serbe në Hilandarë |

14. Deri ku solli krijimi i shteteve gjermane në Europë dhe Mesdhe në fund të kohës së vjetër?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- | | |
|--|--|
| ☐ rënia e Perandorisë Romake Perëndimore | ☐ përhapja e islamit |
| ☐ zbulimet e mëdha gjeografike | ☐ rënia e Bizantit |

15. Në bazë të fragmentit në tekst të burimeve historike përcakto për cilën ngjarje është fjalë.

„[...] Popullit tim të dashur, interesat më të larta popullore dhe shtetërore dhe ardhmëria e tyre më obligojnë si udhëheqës dhe si djal i kësaj toke i drejtohem popullit [...] Erdhi koha, ku në mes opoullit dhe mbretit sdo të ketë ndërmjetësues. Për këtë arsye vendosa që kushtetuta e mbretësisë SKS prej 28.VI.1921. nk të vazhdojë më kuvendi Popullor i zgjedhur më 11. XI. 1927. Shpërndahet. [...]”

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- | | |
|---|--|
| ☐ shpalljen e mbretërisë | ☐ instalimin e diktaturës |
| ☐ sjellja e Kushtetutës së re | ☐ paraqitja e parlamentarizmit |





16. Në bazë të fragmentit të burimeve historike përcakto cilës periudhë kohore i takon.

„[...] Duke pasë parasysh deklaratën universale për të drejtat e njeriut të cilën kuvendi Gjeneral i kombeve të Bashkuara shpalli [...] Duke pasë parasysh se qëllimi i këshillit të Europës arritjet e bashkimit më të madh të anëtarëve të saj dhe në ruajtjen dhe zhvillimit të drejtave të njeriut dhe liritë elementare të njerëzve një nga mënyrat që duhet të punohet në atë drejtim [...]”

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- | | |
|---|--|
| ☐ në filim të Luftës së Parë Botërore | ☐ në fund të Luftës së Parë Botërore |
| ☐ gjatë Luftës së Dytë Botërore | ☐ pas Luftës së Dytë Botërore |

17. Për cilën nga ngjarjet historike lidhet termi „Plani Marshall”?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- | | |
|--|--|
| ☐ plani i hyrjes së SHBA në luftën e Parë botërore më 1917. | ☐ shpallja e luftës e SHBA-së ndaj Japonisë pas sulmit në Pearl Harbour më 1941. |
| ☐ programi i ndihmës së SHBA-ve vendeve të shkatërruara të Europës pas vitit 1945. | ☐ doktrina ushtarake themelimi i NATO-s më 1949. |

18. Për cilën prej ngjarjeve historike lidhet termi „Nata e Kristaltë”?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- | | |
|---|---|
| ☐ ndjekja e protestantëve në Francë më 1572. | ☐ sulmi në pallatin mbretëror në Rusi më 1917. |
| ☐ ndezja e kuvendit popullor në Gjermani më 1933. | ☐ ndjekja e Hebrenjëve në Rajhun e Tretë më 1938. |

19. Si quhet kryeministri i Serbisë i cili ishte në krye të qeverisë në periudhën prej 25 Janar 2001, deri më 12 mars 2003?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- | | | | |
|---|--------------------------------------|-----------------------------------|---------------------------------------|
| ☐ Vojislav Koshtunica | ☐ Zoran Gjingjiq | ☐ Boris Tadiq | ☐ Zoran Zhivkoviq |
|---|--------------------------------------|-----------------------------------|---------------------------------------|

20. Lexo me kujdes fragmentin nga burimet historike dhe përgjigju në pyetjen.

„Kohëra të vështira të kaluarës sime serbe, ishin ngushtë të lidhura me jetën time, ashtu siç ishin të ndryshueshme, ashtu edhe jeta ime ishte e ndryshueshme. Unë kam shërbyer dhe zotëruar, priftëruar dhe udhëhequr; udhëtuar për punë të popullit nga shtëpia në shtëpi qetë i ulur në kopshtin tim dhe pemët duke i shartuar; kam pri luftëra të rrezikshme dhe shijuar dhurmin e qatësisë së përgjithshme [...] Të gjitha këto ndryshime në jetën time [...] ku diku isha, më shfaqet endrra e rinisë sime.”

Për cilin lloj të burimit historik bëhet fjalë?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- | | | | |
|--------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|------------------------------|
| ☐ biografi | ☐ memoare | ☐ shkrime | ☐ ditarë |
|--------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|------------------------------|



FAQE E ZBRAZËT



Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

Историја - Албански

ИНТЕРНО

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI

HISTORI

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE
VENDI
KOMUNA

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

